



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 74 datë 19.12.2024

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM TË PASURISË ME
NUMËR 3/1034, ZONË KADASTRALE 8593 “TREGU RUS”, NË FAVOR TË
SHOQËRISË AKSIONERE BIO STRAJCA”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në nenet 9, pika 1.2 germa a), nenit 28 pika 2, nenit 54 germa e/1, të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligjin Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM Nr.421, datë 02.06.2010 “Për Miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, Çertifikatën e regjistrimit të pronësisë me Nr. pasurie 3/1034, ZK8593; VKB-në Nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, Shkresën Nr. 7981, datë 16.04.2024, *Kërkesë për transferimin e administrimit të tregut “Merkata Rus”, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,*

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie në përdorim pa kundërshtëpërblim të pasurisë me numër 3/1034, zona kadastrale 8593 Shkodër “Tregu Rus”, në favor të Shoqërisë Aksionere “Bio Strajca”, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimit dhe të menaxhimit të Tregut Rus.

2. Afati për të cilën kjo pasuri jepet në përdorim do jetë 5 (pesë) vite .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 31 vota
Vota Pro 31
Vota Kundër 14
Vota Abstenim 2
Zbardhur me datë 20.12.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LUKI

